

AKTIVIZOHU DHE NDRYSHO



DEMOKRACIA SI QEVERISJE E LIRË DHE E MIRË

VIKTOR (10), VENERA (10), EROLIND (10), ENIS (11), MEDINA (11), MARIGONA (11), LORIK (11)



Artikulli ynë flet për demokracinë dhe llojet e saj. Flet gjithashtu për të drejtat tona si qytetarë të Kosovës demokratike

Ne si qytetarë demokratik jetojmë në bazë të këtyre elementeve: tolerancës, solidaritetit, barazisë, respektit dhe paqes. Këto elemente që i përmendëm, janë elementet kryesore të demokracisë.

Marrim shembull, ne jetojmë në bazë të tolerancës në Kosovë sepse në vendin tonë kemi tri fe kryesore, e ato janë: feja islame, katolike dhe ortodokse. Mirëpo, përkundër fesë ne të gjithë në Kosovë jetojmë të lumtur dhe në harmoni. Pra, jemi një shtet shumë tolerant që nuk kemi bërë asnjëherë luftë për fe.

Demokracia lindi në vitin 507 para lindjes së Krishtit, në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Demokracia në atë kohë ishte krejt ndryshe, sepse atëherë votonin vetëm burrat e pasur. Kurse, në demokracinë e tanishme jemi të gjithë të barabartë, pavarësisht fesë, racës, gjinisë, kombit apo gjendjes ekonomike. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ popull dhe „kratia“ qeverisje. Të mos harrojmë të përmendim faktin se në demokraci, ne si popull kemi shumë të drejta. Këto të drejta janë: e drejta e shkollimit, e lojës, e shprehjes së lirë, e strehimit etj.

Demokracia sot është shumë më e kompletuar si dhe më e plotë se në të shkuarën. Kemi dy lloje kryesore të demokracisë, ato janë: përfaqësuese dhe e drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese është atëherë kur

populli me anë të votës zgjedh përfaqësuesit e vet. Ndërkaq, ajo direkte kur populli i merr vendimet aty për aty.



Ne të gjithë e kemi drejtën e familjes



Autorët e artikullit duke punuar

VOTIMI BËN NDRYSHIM

ERZA (10), ERËZA (10), EMIRA (10), ADRIATIK (10), ERMELINA (11), ENDI (11)

Lexues të dashur, nga ne do të mësoni se pse zgjedhjet janë element i rëndësishëm i demokracisë

Ndër elementet më të rëndësishme të demokracisë janë zgjedhjet. Me anë të zgjedhjeve populli zgjedh përfaqësuesit e vet, që për detyrë kanë t'i përfaqësojnë interesat e popullit. Të drejtë vote kemi nga moshë 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të pjekur dhe e dimë më mirë se kë duhet ta votojmë. Janë dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet lokale. Në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët, kurse në zgjedhjet lokale, zgjedhen kryetarët e komunave dhe asambleistët e komunave. Votimi është proces shumë i rëndësishëm i një vendi, sepse me anë të tij populli e shpreh mendimin e tij lirshëm, prandaj ju ftojmë të gjithë juve që e lexoni këtë artikull të votoni, sepse votimi është përgjegjësi e çdo qytetari të Republikës së Kosovës.




Gazetarët e demokracisë



Votimi është proces shumë i rëndësishëm i një vendi



Të gjithë kemi të drejtën e votës në moshën 18 vjeçare



Me anë të votës së qytetarëve, zgjedhen deputetët e vendit




Voto dhe ndrysho të ardhmen tënde




Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik




Kuvendi i Republikës së Kosovës merr vendime të rëndësishme për të gjithë ne



Të drejtën për të votuar e kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës



Zgjedhjet janë zemra e demokracisë



Demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtpërdrejtë janë dy llojet e demokracisë



Ne, nxënësit e shkollës „Zene Hajdini“ sot mësojmë për demokracinë dhe elementet e saj

TRI DEGËT E PUSHTETIT

YLLI (10), ENSAR (11), ALTIN (11), RINESA (10), AULONA (10). ELMEDINA (10)




Ne jemi gazetarë të vegjël dhe do t'iu tregojmë për gjërat e reja që i kemi mësuar ne për demokracinë dhe ndarjen e pushtetit

Në fillim do t'iu tregojmë për demokracinë. Me fjalën demokraci kuptojmë qeverisjen e popullit. Edhe vet fjala demokraci do të thotë qeverisje e popullit. Por si qeveris populli? Populli qeveris me anë të votave. Kur ne shkojmë dhe votojmë, ne zgjedhim ata të cilët udhëheqin shtetin tonë. Tash do t'iu tregojmë për Kuvendin e Kosovës. Deputetët të cilët punojnë në Kuvendin e Kosovës votohen nga të gjithë qytetarët e vendit. Në Kosovë kemi 120 deputetë. Këta deputetë janë shqiptarë, mirëpo ka edhe serbë, turq, ashkalinjë, romë, egjiptianë, dhe boshnjakë. Detyra kryesore e Kuvendit është të shkruaj dhe të miratoj ligjet e Kosovës. Për atë ne e quajmë Kuvendin institucion legjislativ. Këto ligje pasi të miratohen shkojnë në Qeveri. Aty ligjet zbatohen ose ekzekutohen. Ne kemi mësuar gjithash-

tu se Qeverinë e udhëheq Kryeministri dhe ministrat. Qeverinë ne e quajmë institucion ekzekutiv. Më pastaj, ne mësuar për gjykatat. Gjykatat i gjykojnë njerëzit të cilët dyshohet se e kanë shkelur ligjin. Në Kosovë kemi tri gjykata, dhe ato janë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, dhe Gjykata Supreme. Të gjitha këto Gjykata i quajmë institucione gjyqësore. Këto institucione që i përmendëm duhet të kontrollojnë njëra-tjetrën në mënyrë që të mos ngatërrohen punët. Punët duhen të jenë të ndara në mënyrë që ato të përfundohen më mirë. Kjo do të ndodhte edhe nëse ne do të ndërtonim një shkollë të re. Për këtë, neve do të na duhej një arkitekt, një dizajner, disa muratorë, disa persona që ndërtojnë shkallët, disa njerëz që ndërtojnë dyshemenë, etj. Mirëpo, të gjithë këta persona duhet të punojnë së bashku që të ndërtohet një shkollë e fortë dhe e bukur. Gjithashtu, duhet të dëgjohet zëri i qytetarëve në demokraci.



Gazetarët e vegjël



Kuvendi, Qeveria dhe Gjykata



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Zenel Hajdini“
Klasa: V-3
Vendi: Prishtinë